



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 721 Prot

Tiranë, më 21.05.2009

VENDIM Nr. 4 dt. 20.05.2009

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 20.05.2009, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara nga Këshilli Shkencor pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës:

VENDOSI:

I. Të miratojë projektet e restaurimit:

1. Punime restauruese të fasadës hotel Argjiro, Gjirokastrë.
2. Restaurimi i ndërtesës hotel Sopot, Gjirokastrë.
3. Projekt restaurimi i ndërtesës Zigai, Pazar, Gjirokastrë.
4. Restaurimi i dyqanit të Rustem Majkos, Gjirokastrë. **(Qepenat të bëhen të fshehur)**
5. Restaurim i dyqanit të konfeksioneve, Gjirokastrë.
6. Restaurim i dyqanit në mesin e pazarit, Gjirokastrë (Myftinia).
7. Restaurimi i objektit Xhaxhiu në Pazarin e Gjirokastrës. **(Dritaret anësore dhe dera ballore të përshtaten me arkitekturën tradicionale).**
8. Restaurim i fasadës së ish punëtorisë, Gjirokastrë.
9. Restaurimi i ndërtesës para obeliskut në Pazarin e Gjirokastrës.
10. Restaurim i banesës së familjes Toto në pazarin e Gjirokastrës.
11. Çatia pranë Obeliskut, Gjirokastrë.
12. Nderhyrjet restauruese në qendrën e Tragjasit të vjetër, Vlorë.
13. Projekte konservimi Butrint 2009.

II. Të shikohet nga ana ligjore problematika e kërkesës për rikonstrukcion:

1. Kërkesë për leje rikonstrukcioni ish ambientet e Institutit të Arkeologjisë dhe palestrën sportive në zgjatim të saj.

Do të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme përkatëse të kësaj lloji të dritës, si më poshtë:

Diskutimi i projekteve të cilat presin financim:

1. Projekti i ndriçimit dekorativ dhe profesional i ansamblit të lagjes Mangalem, Berat.

Shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve, për ndërhyrje në objekte:

1. Banesa, Halil Myderrizi, Durrës.
2. Banesa, Dhimitër Ikonomi, Berat.

Diskutimi i kërkesave për licensë:

1. Ajet Nallbani. Kërkesë për pajisje me licensë të kat A
2. Lida Miraj. Kërkesë për pajisje me licensë të kat A

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
ARDJAN TURKU**



**SEKRETAR I KKR
PROF. DR. VALTER SHTYLLA**

